

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Për: **“Vellezerit Hysa” sh.p.k.** me adresë: Fshati Banje e Re, Klos, Bashkia Cerrik, Elbasan.

Procedura e prokurimit: **“Proçedurë e Hapur”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Sistemim-Asfaltim rruga Broshkë dhe ura mbi lumin Shkumbin”**, me fond limit: **103,261,997** (njëqind e tremilion e dyqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) **lekë** (pa tvsh), vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2016 miratuar me Vendimin e Komitetit Për Zhvillimin e Rajoneve nr.31, datë. 13.06.2016 “Për Shpërndarjen e Financimit për Projekte te Grantit "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale", programi "Zhvillimi I Infrastruktures Vendore dhe Rajonale", Shtylla I, Thirrja II, per vitin 2016”, dhe me afat per perfundimin e punimeve **5** (pese) **muaj** nga data e nenshkrimit te kontrates .

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [01.08.2016] [30]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. “Vellezerit Hysa” sh.p.k. me Nipt: K 12911201C

Vlera e paraqitur ne proceduren e prokurimit është **95.408.928** (nentedhjete e pesemilion e katerqind e tetemije e nenteqind e njezet e tete) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **114.490.714** (njeqind e katermbedhjetemilion e katerqind e nentedhjetemije e shtateqind e katermbedhjete) **lekë** (me tvsh).

2. “Eral construction company” sh.p.k me Nipt: K 82230002 K & “Alba Konstruksion” sh.p.k me Nipt: J 61812013 R

Vlera e paraqitur ne proceduren e prokurimit është **87.746.404,32** (tetedhjete e shtatemilion e shtateqind e dyzet e gjashtemije e katerqind e kater presje tridhjete e dy) **lekë** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **105.295.685,18** (njeqind e pesemilion e dyzqind e nenedhjete e pesemije e gjashteqind e tetedhjete e pese presje tetembdhjete) **lekë** (me tvsh).

3. “Alko- Impex General Construction” sh.p.k. me Nipt: K 91326028 I

Vlera e paraqitur ne proceduren e prokurimit është **98,912,219** (netedhjete e tetemilion e nenteqind e dymbedhjetemije e dyqind e nentembdhjete) **leke** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **118,694,663** (njeqind e tetembdhjetemilion e gjashteqind e nentedhjete e katermije e gjashteqind e gjashtedhjete e tre) **leke** (me tvsh).

4. “Victoria Invest” sh.p.k. me Nipt: K 32712206 U

Vlera e paraqitur ne proceduren e prokurimit është **92.811.393,34** (nentedhjete e dymilion e teteqind e njembdhjetemije e treqind e nentedhjete e tre presje tridhjete e kater) **leke** (pa tvsh) dhe me vlerë kontrate prej **111.373.672,01** (njeqind e njembdhjetemilion e treqind e shtatedhjete e tremije e gjashteqind e shtatedhjete e dy presje zero nje) **leke** (me tvsh).

Ofertues te skualifikuar jane tre operatore.

-Ofertuesi **“Eral construction company”** sh.p.k me Nipt: K 82230002 K & **“Alba Konstruksion”**

sh.p.k me Nipt: J 61812013 R

- Ofertuesi **“Alko- Impex General Construction”** sh.p.k. me Nipt: K 91326028 I

- Ofertuesi **“Victoria Invest”** sh.p.k. me Nipt: K 32712206 U

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1-Ofertuesi “Eral construction company” sh.p.k & “Alba Konstruksion” sh.p.k skualifikohet per

arsye se:

- Ne lidhje me kriterin: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës të vlefshme për kohëzgjatjen e kontratës që prokurohet dhe dëshmitë e drejtimit të leshuara nga D.P.SH.T Rrugore, për të paktën **4 (katër)** manovratorë të makinave të rënda, nga te cilet 1 (një) Automaknist dhe 3 (tre) eskavatorist. Operatori ekonomik Eral construction company nuk ka paraqitur asnjë dokumet të kerkuar ne DST ne permbushje te ketij kriteri dhe si rrjedhoje nuk e permbush kete kriter ne lidhje me perqindjen e pjesmarrjes se tij ne kete JV. Ndersa Operatori ekonomik Alba Konstruksion nga shtate manovratore ka vetem 6 kontrata, nga te cilet nga listpagesat figurojne, 2 shofer kamioni, 3 drejtues te makinerive frigoriferike dhe 1 drejtues fadrome. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**
- Ne lidhje me kriterin: Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) punonjës të kualifikuar si mëposhte: Inxhiner ndërtimi me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 1(një); Punonjës elektrikist me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 2(dy); Punonjës hidraulik me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 2(dy); Punonjes saldator me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 1(nje). Operatori ekonomik Alba konstruksion ka paraqitur vetem kontrata pune pa e shoqeruar me deshmi IQT ose anolegen e saj si eshte kerkuar ne DST dhe si rrjedhoje nuk e ka permbushur kete kriter ne lidhje me perqindjen e pjesmarrjes se tij ne kete JV. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**
- Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate furnizimi noteriale me prodhuesin e shoqeruar me çertifikate ISO per keto zera punimesh: -F.v. shtylla dekorative per ndricim sipas specifikimeve teknike. -F.v. ndriçues projektor me llampe SAP sipas specifikimeve teknike. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ISOT e kerkuara ne DST. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**
- Ne lidhje me kriterin Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e më poshtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës operatori nuk e permbush kete kriter. Në DST percaktohet se: Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve. Nisur nga kjo e drejte Autoriteti kontraktor ka verifikuar nese subjekti i disponon mjetet e paraqitura sipas shtojces 9 ne adresen Vore, Tirane, adrese e percaktuar ne deklaraten e drejtueses ligjore te shoqërisë Z. Ervin Qendro. Nga verifikimi I datës 26.09.2016 rezultoi se ne kete adrese nuk ka mjete por vetem magazina. Ndersa operatori ekonomik Alba Konstruksion ne deklaraten e administratorit Xhavit Ismaili percakton se mjetet ndodhen ne parkun e shoqerise sone pa percaktuar adresen ashtu si dhe kerkohet ne DST duke e bere te pamundur KVO te bej verifikimin e tyre. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**

2-Ofertuesi “**ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION**” sh.p.k. skualifikohet per arsye se:

- Ne lidhje me kriterin se duhet te paraqese Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore. Per subjektin Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k ka paraqitur nje vertetim i cili dhe pse i noterizuar nuk permban asnje vule institucionale. Ky dokument nuk konsiderohet ligjor. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**
- Ne lidhje me kriterin: Operatori ekonomik te paraqese nje vertetim qe ka paguar taksat dhe tarifate vendore per vitin 2015 dhe 2016 per çdo vend te ushtrimit te aktivitetit. (Në rastet e

bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese vertetimin per tarifat dhe taksat vendore). Per subjektin Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k nuk ka paraqitur taksat vendore te vendeve te ushtrimit aktivitetit: Vushtrri/Smrekovnic dhe Fushe Kosove /Nakarade te cilat figurojne aktive ne baze te Certifikates se Regjistrimit te dates 10.12.2014 te paraqitur nga operatori si anologe te QKR-se ne shtetin Shqiptare. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**

- Ne lidhje me kriterin: Operatori ekonomik te paraqese Kopjet e certifikuara të bilanceve per vitet 2013, 2014 dhe 2015, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse e të konfirmuara nga ky autoritet. Per subjektin Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k ka paraqitur nje dokument i cili permban 30 flete dhe qe shoqerohet nga Vertetimi noterial i cili unifikon kopjen me origjinalin te nje dokumenti me 6 flete A4 dhe gjithashtu ne kete vertetim noterial nuk specifikohet as emertimi apo specifika te aktiti qe po njesohet me origjinalin. Legalizimi i dokumentacionit qe leshohet nga institucionet analoge te atyre Shqiptare behet ne zyrat perkatese mbi origjinalin e dokumentit ose mbi aktin noterial. Por ne kete rast ajo cka verteton akti noterial nuk perputhet me dokumentacionin qe shoqeron. Per sa me siper ky dokument nuk konsiderohet ligjor dhe nuk merret ne shqyrtim. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**
- Ne lidhje me kriterin se duhet te paraqese Nje punesim mesatar i te pakten 105 personave të siguruar përperiudhen Janar 2014 – Qershor 2016. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; dhe List-pagesat e punonjësve të konfirmuar nga Administrata Tatimore shoqeruar me formularet e deklarimit te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore (FDP), formularet e deklarimit te te ardhurave nga punesimi (TAP), Listapagesat e vitit 2014 dhe 2015 te paraqitura nga dega e shoqerise ne Shqiperi nuk jane te konfirmuara nga Administrat Tatimore si dhe eshte kerkuar ne DST. Gjithashtu dega e shoqerise nuk e permbush e vetme numrin mesatar te punonjesve te kerkuara ne DST sepse numri mesatar i punonjesve eshte 55.73 puntore. Listpagesat e vitit 2015 dhe Janar-Qershor 2016 e subjektit Meme ALKO-IMPEX General Construction sh.p.k nuk merren ne konsiderate. Keto dokumenta permbajne 4 flete nderkohe qe vertetimi noterial unifikon vetem 1 flete A4 pa percaktuar se cili eshte ky dokument. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**
- Ne lidhje me kriterin: Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar minimalisht **6 (gjashtë)** punonjës të kualifikuar si mëposhtë Inxhiner ndërtimi me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 1(një); Punonjës elektrikist me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 2(dy); Punonjës hidraulik me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 2(dy); Punonjes saldator me kualifikime teknike nga IQT (ISHTI-sot) 1(nje). Operatori ekonomik ka paraqitur nje deklarat se ne Kosove nuk ka dokument analog te kualifikimit teknike nga IQT (ISHTI-sot) por ka deklaruar nje list personash me specialitet perkatese. Keto dokumenta nuk jane te mjaftueshem per te permbushur kete kriter pasi: per personat e deklaruar nuk ka kontrata pune qe mbulojne kohezgjatjen e objekteit si dhe eshte kerkuar ne DST. Per keta persona puk paraqitet asnje dokument si diplome ose certifikata kualifikimi per te vertetuar se cilat jane kualifikimet dhe profesionet e tyre. Dhe nga listpagesat e shoqerise nuk ka asnje te dhene qe te vertetoj se cili eshte profesioni per te cilen jane kontraktuar dhe paguhen keta persona. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**

- Ne lidhje me kriterin: Operatorët ekonomikë duhët të paraqesin kontratat individuale të punës të vlefshme për kohëzgjatjen e kontratës që prokurohet dhe dëshmitë e drejtimit të leshuara nga D.P.SH.T Rrugore, për të paktën **4 (katër)** manovratorë të makinave të rënda, nga te cilet 1 (një) Automakinist dhe 3 (tre) eskavatorist. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur kontrata individuale te punes te vlefshme per te gjithë kohezgjatjen e kontrates si eshte kerkuar ne DST. **Operatori ekonomik nuk kualifikohet ne lidhje me kete kriter.**

3- Ofertuesi “Victoria Invest” sh.p.k. skualifikohet per arsye se:

- Operatori ekonomik nuk ploteson kriterin per Disponimin ose mundësinë e sigurt të disponimit në paisjet/kapacitetet e më poshtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, pasi mjetet e paraqitura ne deklarimin për disponimin e makinerive (sipas shtojces 9) të shoqëruar me dokumentat perkatese jane te gjitha te angazhuara ne objektin “Sistemim asfaltim i rruges Rinia “ te kontraktuar me Autoritetin Kontraktor Bashkia Elbasan.
- Ne lidhje me kriterin: Nje punesim mesatar i te pakten **105** personave të siguruar për periudhen **Janar 2014 – Qershor 2016**. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e kerkuar ne DST por njekohesisht ka tre kontrata ne vazhdim te lidhura me Bashkine Elbasan dhe fuqia puntore e paraqitur prej tij eshte e angazhuar ne keto kontrata ne vazhdim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“Vellezerit Hysa”**

sh.p.k. me adresë: Fshati Banje e Re, Klos, Bashkia Cerrik, Elbasan, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **95.408.928** (nentedhjete e pesemilion e katerqind e tetemije e nenteqind e njezet e tete) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkise Elbasan (Drejtoria e Prokurimeve)**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **20 (njezet) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “ Per Prokurimet Publike ”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 27.09.2016

Ankesa nuk ka patur.